

Shëndeti psiqik

Në Zvicër nuk bëhet dallim në mes sëmundjeve psiqike dhe fizike. Sigurimi bazë e paguan trajtimin e sëmundjeve psiqike te njerëzit e specializuar si dhe qëndrimin në klinik.

Mbështetja dhe këshillimi

Për situata të vështira personale apo familjare ka në Zvicër shumë persona të specializuar të cilët ndihmojnë më tej. Sigurimi bazë (Grundversicherung) e paguan trajtimin te sëmundjet psiqike te njerëzit e specializuar të çertifikuar me ligj si psikiatret dhe psikiatrit. Qëndrimet në klinik po ashtu paguhen. Kush ka probleme, mundet falas me ju drejtue këshillimoreve anonime. Kështu këshillon Dora e Zgjatur (Dargebotene Hand) përmes telefonit, E- Mailt apo chat (telefon 143, www.143.ch). Mirëpo edhe mjekja apo mjeku familjar munden të ndihmojnë. Kur një person është akut i rrezikuar, që vetes apo tjetrit mund t`i bëjë diçka duhet të veprohet shpejt. Në këto raste urgjente ndihmon policia (telefoni 117).

Fëmijët dhe të rinjtë

Për të rinjtë me probleme psiqike është falas shërbimi psikologjik shkollorsi hap i parë i mirë. Edhe prindërit, të cilët brengosen për fëmijët e tyre, munden me u lajmëruë aty. Mbështetje anonime falas për fëmijë dhe të rinjë ofrojnë thirrja emergjente për fëmijë (Kindernotruf) përmes telefonit, E-Mal apo Chat (Tel.147, www.147.ch). Për urgjencat psikiatrike të fëmijëve dhe adoleshentëve, prindërit mund të kontaktojnë klinikën psikiatrike të fëmijëve dhe adoleshentëve të Baselland në 061 553 55 55.

Sëmundjet e vesit

Ndihma ndaj Varësive në rajonin Basel dhe Qendra Multikulturore e Këshillimit për Varësinë beider Basel (MUSUB) ndihmojnë me varësitë. Këto vende ofrojnë mbështetje dhe këshillim në besim falas. Edhe kur njeriu brengoset për për të afërmit dhe personave që ka pranë, mundet t`i kontaktoj qendrat këshilluese. Këto ofrojnë këshillime edhe në disa gjuhë të huaja. Te sëmundjet e vesit nuk numrojnë vetëm vesi i alkoholit-apo drogës. Edhe te veset e tjera si vesi i lojës, i blerjes apo internetit edhe te pengesat në të ngrën ndihmojnë këshillimoret e vesit tutje. Pyetjet mund të bëhen edhe përmes mailit.

Traumatizimi

Kush në jetë përjeton gjëra të këqija dhe nuk mundet t`i harroj, duhet të marr mbështetje. Sepse traumatizimet janë sëmundje që duhet marr seriozisht. Përgjatë këshillimit dhe ofertave mbështetëse për probleme psikike dhe sëmundje ka edhe vende me njerzë të specializuar për trajtime të viktimave të luftës dhe torturës.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/shendeti/shendeti-psiqik